

ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME
FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE
DEKANI

Tiranë më, 02.02.2024

Konferenca ndërkombëtare me temë:

**“SFIDAT E BALLKANIT PERËNDIMOR PËR FORCIMIN E SHTETIT TË
SË DREJTËS DHE LUFTËS KUNDËR KORRUPSIONIT
DHE KRIMINALITETIT”**

Organizuar nga:


Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Albanian University, Tiranë, Shqipëri

Vendi dhe data e organizimit:

Tirana International Hotel, Sheshi “Skënderbej”, Tiranë, Shqipëri
26 dhe 27 prill 2024

Objekti i konferencës:

Ballkani Perëndimor është pjesa e vetme e Evropës Juglindore që nuk i është bashkëngjitur ende Bashkimit Evropian, ndonëse ky i fundit ka konfirmuar të ardhmen evropiane për të gjithë këto vende. Në thelb, pavarësisht qasjeve të fundit për një integrim në bllok, përsëri për shkak të dallimeve të qenësishme, por edhe pengesave të tjera, nuk mungon edhe përkrahja për një qasje vis – a – vis ose sipas meritave të secilit vend. Nga ana tjetër, pavarësisht dallimeve ndonjëherë jo të vogla, një pjesë e madhe e pengesave të pranimit që lidhen me përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit të përcaktuara nga Këshilli Evropian në Kopenhagen në vitin 1993 dhe të forcuara më tej nga Këshilli Evropian i Madridit në vitin 1995, vazhdojnë të mbeten të njëjta në lloje dhe në përmbajtje pavarësisht dallimeve jo të rëndësishme në formën e shfaqjes së tyre dhe karakteristikave të posaçme të vendeve përkatëse. I gjithë rajoni me një të shkuar ish komuniste, trashëgon probleme të shumta, por problemet kryesore më të vështira për t'u kapërcyer mbeten sidomos forcimi i shtetit të së drejtës, lufta kundër korrupsionit dhe kundër kriminalitetit në tërësi.




Në aspektin e shtetit të së drejtës, problemet mbizotëruese janë cënimi i parimit të ndarjes së pushteteve, cënimi i ekuilibrave kushtetues, dështimi jo rrallherë i procesit ligjvënës për të mbrojtur interesin publik, mbrojtja, respektimi dhe promovimi i të drejtave të njeriut, ekzistenca e pushteteve gjyqësore, të pavarur, të paanshëm, profesional dhe të përgjegjshëm, ndalimi i diskriminimit të grupeve të të pambrojtura, zbatimi i detyrimeve të së drejtës ndërkombëtare, etj. Ndërkohë, në aspektin e luftës kundër korrupsionit, ky i fundit mbetet në nivele tepër të larta në krahasim me vendet e BE-së dhe në shumë raste paraqet karakteristika sistematike dhe në përmasa që çënojnë thelbin e shtetit të së drejtës dhe mbrojtjen e interesit publik në tërësi. Korrupsioni për shkak të natyrës të posaçme të tij, cënon jo vetëm marrëdhëniet shoqërore që prek drejtpërdrejtë, por edhe aftësinë e përgjithshme të shtetit për të përmbushur misionin e tij duke përfshirë rënien edhe të aftësisë për të luftuar kriminalitetin dhe për shumë çështje të tjera. Përpjekjet për të luftuar korrupsionin dhe kriminalitetin në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe posaçërisht në RSH, janë në një fazë të rëndësishme, ku strukturat ligjzbatuese kanë forcuar ndjeshëm kapacitetet dhe përgjigjja që gjyqësori po u jep këtyre fenomeneve duket shumë premtuese. Gjithësesi, korniza ligjore e miratuar në Shqipëri përse u përket strukturave të posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe shembulli i punës së organeve përkatëse mund të merret si një model i vlefshëm përtej RSH. Megjithatë, sfidat për të vendosur standardet e munguara të BE-së, vazhdojnë të mbeten për çdo vend përfshirë RSH dhe kërkohet shumë punë dhe një qasje gjithpërfshirëse për të përmbysur situatën aktuale dhe plotësuar kushtet e anëtarësimit në BE. Midis të tjerash, përballja me këto sfida kërkojnë edhe një sistem arsimor dhe programe studimi të zhvilluara që sigurojnë jo vetëm burimet njerëzore, por edhe krijojnë kushtet shoqërore për një integrim të natyreshëm në BE dhe jo një integrim të sforcuar dhe formal.

Konferenca në fjalë, do të ketë një sesion plenar dhe tre sesione të posaçme, të ndara sipas tre departamenteve të fakultetit: ***Sesioni i Shkencave Juridike dhe Politike, Sesioni i Edukimit dhe Anglishtes dhe Sesioni i Psikologjisë.***

Në konferencë do të jenë të ftuar nga institucionet e mëposhtme:

- Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar,
- Gjykata e Lartë
- Gjykata Kushtetuese
- Gjykata Kushtetuese e Kosovës
- Akademia e Shkencave e Kosovës
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë
- Universiteti i Prishtinës
- Etj.

Gjithashtu, pritet të kemi konfirmime pjesëmarrje nga Universiteti i Zagrebit, Universitete të tjera në rajon, studiues e njohës të mirë të Ballkanit perëndimor, përfaqësues nga Universiteti i



Bolonjës, Komiteti i Helsinkut për të Drejtat e Njeriut në Serbi etj, si dhe disa përfaqësues të trupit diplomatik të akredituar në Tiranë. Në konferencë do të marrin pjesë me kumtesa edhe studiues dhe anëtarë të personelit akademik të institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri dhe në vende të tjera të cilët do të shprehin dëshirën për të marrë pjesë mbi bazën e pranimit të punimeve nga Komiteti Shkencor i Konferencës.

Të gjithë autorët e interesuar janë të inkurajuar të kontribuojnë dhe të ndihmojnë në formësimin e kësaj konference, me anë të punimeve të tyre kërkimore shkencore në formatin abstrakt, artikull, poster ose online në gjuhën Angleze dhe Shqipe. Për qëllime të ndërkombëtarizimit, nxitet posaçërisht paraqitja e punimeve në gjuhën Angleze.

Botimi dhe pjesëmarrja:

Kumtesat e paraqitura në konferencë do t'i nënshtrohen një vlerësimi paraprak me blind peer review nga anëtarët e komitetit shkencor dhe persona të tjerë të caktuar nga Komiteti dhe do të botohen në proceedings si dhe në revistën e Albanian University "Optime". Gjithashtu po shikohet mundësia e bashkëpunimit me një revistë të indeksuar në SCOPUS ku botimet do të bëhen mbi bazën e meritave individuale të çdo punimi të paraqitur dhe të pranuar në Konferencë dhe sipas kushteve të vetë revistës.

Pjesëmarrja në konferencë do të jetë falas dhe për kopje të shtypura të punimeve të botuara do paguhet një tarifë prej 10 Euro për kopje.


Kriteret e pranimeve të punimeve:

Çdo studim që dërgohet për t'u botuar u jepet për recension dy studiuesve të fushave ku bën pjesë studimi (peer review). Artikulli botohet nëse të dyja recensat janë pozitive. Nëse njëra është pozitive dhe tjetra negative, artikulli i jepet një recensionuesi të tretë, i cili vendos për botimin ose mosbotimin e artikullit. Pra, detyra e përzgjedhjes së artikujve shkencorë është kompetencë ekskluzive e recensentëve anonimë. Në rastet kur punimi do të botohet në revista që nuk i përkasin Albanian University, kostot e publikimit përballohet nga vetë kontribuesit (autorët), sipas vëllimit të çdo artikulli, ose nga institucionet ku ata bëjnë pjesë sipas kushteteve të vetë revistës.

Çdo artikull duhet të jetë në përputhje me standardet gjuhësore. Artikujt mund të jenë shkencorë ose recensionues, krijime origjinale ose përkthime.

Struktura e artikujve shkencorë duhet të jetë:

- (1) titulli, deri në 15 fjalë;
- (2) autori/autorët (emri mbiemri); institucioni ku është/janë; adresat elektronike – për çdonjërin prej tyre;




- (3) të dhëna për autorin/autorët, 4-6 rreshta, si tekst;
- (4) përmbledhje (shqip-anglisht), me 200-250 fjalë dhe 4-6 fjalë kyçe (5) teksti i artikullit (shoqëruar me referenca të shkurtuara përgjatë tekstit).
- (6) Vëllimi standard për artikujt është deri në 8 faqe kompjuterike.
- (7) Referencat e plota, në fund të tekstit, sipas rendit alfabetik të mbiemrave të autorëve;
- (8) Çdo artikull duhet të dërgohet në formatin word.

[Shënim 1: Përmbledhja/abstrakti përfshin: çështjet tematike/ç'përfaqëson ky punim, pyetjet kërkimore, qasjet teorike, metodologjinë/metodat konkrete të zbatuara, gjetjet/rezultatet dhe përfundimet]

Temat orientuese të sesioneve:

Sesioni i Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko – Administrative:

1. Ndikimi i reformës Kushtetuese në RSH në vitin 2016 në forcimin e luftës kundër korrupsionit dhe kriminalitetit.
2. Mbrojtja kushtetuese e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore.
3. Roli i Presidentit të Republikës në ruajtjen e ekuilibrave midis tre pushteteve.
4. Çështje të rëndësishme kushtetuese të njohjes dhe zbatimit të vendimeve të huaja kombëtare dhe ndërkombëtare duke përfshirë ajo 'quasi' gjyqësore.
5. Kufizimi i të Drejtave të Njeriut në një shoqëri demokratike dhe roli i gjykatave në garantimin e respektimit dhe mbrojtjes së tyre.
6. Përqasja e ligjit procedural dhe material penal me parimet e të Drejtës së Bashkimit Evropian.
7. Nevoja për politika penale që i shërbejnë drejtësisë riparuese dhe rishoqërizuese.
8. Profesionalizmi, përgjegjshmëria dhe paanshmëria e gjyqtarit si gurëthemeli për një proces të rregull.
9. Diskrecioni i organeve publike midis përmbyshjes së funksioneve dhe cënimit të ndarjes së pushteteve.
10. Arsytimi i vendimeve gjyqësore sipas standardeve të GJEDNJ.
11. E Drejta e Sigurisë së Personit.
12. Ankimi individual dhe mbrojtja e të drejtave kushtetuese nga Gjykata Kushtetuese.
13. Pavarësia e prokurorit dhe natyra juridike e udhëzimeve të drejtuesit të prokurorisë sipas K.Pr.P. të RSH.
14. Këndvështrime kushtetuese dhe procedurale të parimit të të provuarit të fajësisë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.



15. Akti normativ dhe pavlefshmëria e tij.
16. Kuptimi ligjor i grupit të interesit dhe 'Actio Popularis'.
17. Raportet hiarkike midis normave kushtetuese në funksion të drejtësisë kushtetuese.
18. Imuniteti shtetëror në praktikën e gjykatave ndërkombëtare të arbitrazhit.
19. Statusi i Urdhrit Evropian të Arrestit në vendet candidate për anëtarësim në BE që kanë nënshkruar marrëveshje stabilizim asociimi.
20. Parimi i prezumimit të pafajësisë dhe transferimi i barrës së provës në procedimet 'in rem'.
21. Legjitimimi 'ratione personae' për ankimin individual të subjekteve të kushtëzuara për të drejtat kushtetuese.
22. Gjykimi Kushtetues i objektivave sociale.
23. Automatizimi kompjuterik dhe procedural i drejtësisë: sfidat e ruajtjes së natyrës humane të drejtësisë dhe garantimi i një procesi të rregullt.
24. Mundësia e marrjes së vendimeve me vlerë 'erga omnes' nga Gjykatat e Larta si instrument që rrit ekonominë gjyqësore dhe efikasitetin e Gjykatave të Larta në kontrollin dhe disiplinimin e praktikës gjyqësore.
25. Sfidat kushtetuese e ligjore të luftës ndaj krimit ndërkufitar dhe nevoja për hetime me grupe të përbashkëta hetimore ndërkufitare.
26. Fuqia prapavepruese e ligjit favorizues penal gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal.

Personi i kontaktit: Msc. Klaudia Capi


Email: k.capi@albanianuniversity.edu.al

Sesioni i Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes:

1. Njohja dhe zbatimi i ligjit të arsimit parauniversitar nga mësuesit.
2. Drejtime teorike dhe empirike (pedagogjike, psikologjike, sociale) në fushën e përkujdesit ndaj fëmijëve apo personave me nevoja të veçanta
3. Zbatimi i ligjit në institucionet e përkujdesit shoqëror për fëmijët.
4. Të drejtat e fëmijëve në arsimin parauniversitar.
5. Përmirësimi dhe zbatimi i Strategjive dhe Politikave sociale në fushën e edukimit.
6. Politikat arsimore në Shqipëri qasje për një arsim global.
7. Shkolla dhe roli i saj në shoqëri.

Personi i kontaktit: Dr. Gilberta Hadaj

Email: g.hadaj@albanianuniversity.edu.al



Sesioni i Departamentit të Psikologjisë:

1. Shteti i së Drejtës dhe shëndeti mendor në popullatë.
2. Roli i Psikologut në proceset integruese.
3. Qasje të zhvillimit të kriminalitetit dhe rëndësia e njohjes së faktorëve psikogjenik.
4. Modelet biopsikosociale në proceset zhvillimore dhe impakti sistemik tek individ.
5. Përplasjet kulturore në proceset integruese dhe ngadalësia në ndrsyshimin e mendësisë.
6. Njohja me dhunën dhe parandalimi i akteve dhunuese.
7. Sistemet e drejtësisë sociale dhe shëndeti mendor .
8. Efektet mediatike mbi sjelljen.
9. Zhvillimi human, zhvillimi teknologjik dhe sjella.
10. Mirëqenia sociale dhe subjektive (psikoemocionale).
11. Perspektiva psikologjike mbi korrupsionin.
12. Rëndësia e stabilizimit emocional për arritjen e mirëqenies psikofizike dhe sociale.
13. Qasja bihejvioriste ndaj fenomenit të korrupsionit.
14. Psikopatologjia e korrupsionit.
15. Teoria konjitiviste e korrupsionit.

Personi i kontaktit: Dr. Arbjola Halimi

Email: a.halimi@albanianuniversity.edu.al

Data të rëndësishme:

Afati për pranimin e abstrakteve	30 mars 2024
Njoftimi për pranimin e abstraktit	2 prill 2024
Afati për dorëzimin e punimit	10 prill 2024
Data e konferencës	26 – 27 prill 2024

Miratoi:

DEKANI

Prof. Asoc. Dr. Jordan DACI